



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSEHM

Nr. _____ Prot.

Peqin, më _____._____.2021

M I R A T O H E T
KRYETARI I BASHKISE
Lorenc TOSKU

RAPORTI VJETOR PËR VEPRIMTARINË E AUDITIMIT TË
BRENDSEHM VITI 2020.

1. Përmbledhje e analizës mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Peqin, gjatë vitit 2020.

Raporti vjetor i veprimtarisë së S.A.B është i fokusuar në drejtimet kryesore të cilat prezantojnë rezultatet e arritura në kete njesi te pushtetit lokal, gjatë vitit 2020, përcjelljen e problemeve të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, veprimet korigjuese dhe përpjekjet e vazhdueshme të stafit dhe administratës së Bashkisë, njësi vartëse për të siguruar zbatimin e rekomandimeve në pajtueshmëri me kuadrin ligjor e të përhershëm, por dhe mangesite dhe te metat e evidentuara per tu permiresuar pergjate vitit ne vazhdim.

Venja ne eficence dhe aplikimi i funksioneve të auditimit të brendshëm ne bashki dhe strukturat vartese kohet e fundit, ka mundësuar ndjeshem parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e rasteve abuzive, të keqmenaxhimit të burimeve financiare, duke u përdorur si instrument, për rritjen e performancës në Bashkinë Peqin.

Si një mekanizëm që siguron në mënyrë të vazhdueshme Këshillin Bashkiak dhe Kryetarin e Bashkise që fondet publike janë përdorur për qëllimin për të cilin ato janë destinuar dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, auditimi i brendshem ka ofruar siguri te arsyeshme dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale te stafit.

Kjo njesi eshte munduar dhe perpjekur qe nepermjet ndihmes dhe bashkepunimit me njesi te tjera analoge te subjekteve te tjera publike si dhe ndihmes dhe bashkepunimit me strukturat perkatese te bashkise dhe Kryetarin e saj, te ushtroje detyrat funksionale ne drejtim te kryerjes se auditimeve ne baze te programit te miratuar per periudhen e vitit 2020 si dhe ka kryer edhe angazhime të tjera tematike të diktuar nga ana e titullarit duke u bërë pjesë e dosjes së auditimit.

Paraqet përgjegjshmërinë e programuesve të auditimit, i cili është marrë me menaxhimin e burimeve, treguesit e saj, matësit e shkallës së performancës dhe rritjen e nivelit të standarteve profesionale të gjithsecilit. Auditimi dhe shkalla e kontroleve në drejtim të minimizimit të riskut ka shkuar në pajtim me përgjegjshmërinë dhe reformat e kryera në sektorin publik.

Veprimtaria e S.A.B.-së ka funksionuar mbi bazën e planifikimit të planit strategjik, vjetor dhe atij të kryerjes së angazhimit, e fokusuar sidomos në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brëndshëm të subjektit të audituar, evidentimin, menaxhimit e riskut dhe të proceseve të qeverisjes, të burimeve të përdorura nga informacionet e rëndësishme financiare të drejtimit të vlerësuara saktë e të besueshme.

S.A.B. e ka ushtruar veprimtarinë e tij audituese brënda autoritetit, objektit, misionit dhe qëllimit sipas të drejtave dhe statusit ligjor funksional.

Spektori i A.B.-së për vitin 2020 ka pasur si objektiva kryesore:

- Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brëndshëm dhe dhënien e rekomandimeve të nevojshme për përmirësimin e tij në subjektet që është kryer auditimi.
- Të bëjë përpjekje lidhur me minimizimin e kostos së auditimit duke e përqëndruar punën në sistemet apo fushat me risk të lartë e të mesëm.
- Të ndjekë në vazhdimësi përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga auditimet bazuar në planin për ndjekjen e tyre.
- Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim.

Aktiviteti i S.A.B.-së i është përmbytur në mënyrë korrekte planit vjetor të miratuar, me ndryshimet e bëra me dije me shkresën nr 2204 prot, datë 14.12.2020 dërguar pranë MFE, *(për shkak të pandemisë së tejzgjatur si pasojë e virusit COVID-19, si dhe auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të kryer pranë Bashkisë sone nga Grupi i audituesve të KLSH në periudhën 02.06.2020 deri me 30.06.2020)* por njëkohësisht pa u shmangur nga plani me ndryshimet, ka kryer edhe angazhime të tjera tematike të diktuar nga ana e Titullarit duke u bërë pjesë e dosjes së auditimit. Nga subjektet e audituara kemi konstatuar gadishmëri të plotë për vënien në dispozicion të ambjentëve dhe dokumentacionit të kërkuar. Në përfundim të çdo misioni auditimi, kemi kërkuar nga menaxhimi hartimin e planit të veprimit **“Për masat në zbatim të rekomandimeve”, (Formati standart nr.10 “modeli i plan veprimit i plotësuar rekomanduar nga grupi i auditimit dhe subjekti i audituar për zbatim”)**, të pranuar të cilat pas kohës në dispozicion janë depozituar në dosjet përkatëse, por theksojmë se ato rishikohen dhe realizohen në auditimet pasardhëse në subjektet respektive.

Spektori i auditimit të brëndshëm në Bashkinë Peqin, është krijuar në zbatim të ligjit nr.10318, datë 16.09.2010, ndryshuar me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 **“Për Auditin e Brëndshëm në Sektorin Publik”**, në VKM nr.345, datë 01.06.2004 **“Për miratimin e manualit, të procedurave të auditimit të brëndshëm publik, të kodit etik dhe kartës së auditit të brëndshëm publik”**.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brëndshëm, të pasqyruara në raportet e auditimit, janë detajuar dhe analizuar gjatë zhvillimit të këtij raporti, në të cilin përshkruhet struktura organizative dhe burimet e sektorit të auditimit, analiza e programeve të auditimit për vitin 2020 dhe misionet specifike, trajtimi i fushave me risk të lartë dhe gjetjet kryesore sipas sistemeve, vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brëndshëm, etj.

Një vend të rëndësishëm në këtë raport, zënë rekomandimet e propozuara dhe reagimi i menaxhimit lidhur me zbatimin e tyre.

Si çështje të veçante raporti përfshin rezultatet nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Peqin të trajtuara në mënyrë specifike si tek gjetjet e auditimit ashtu dhe tek rekomandimet e adresuara për përmirësimin e situatës në këto sisteme.

Për periudhën Janar-Dhjetor/2020 sektori i auditimit të brëndshëm në Bashkinë Peqin, ka funksionuar i plotë, me një përgjegjësi dhe dy punonjës auditues, nga të cilët përgjegjësi i sektorit është i certifikuar, ndërsa është në proces certifikimi një auditues, janë kryer 8 (tete) misione auditimi kundrejt 12 (dymbëdhjetë) misionëve të programuara në fillim të vitit dhe 8 misionëve të programuara pas rishikimit të programit të auditimit për efekt të pandemisë, dërguar me shkresën nr 2204 prot, datë 14.12.2020 pranë MFE.

Nisur nga objektivi që ka Auditimi i Brëndshëm për dhënie të sigurisë së arsyeshme drejtimit dhe menaxhimit, se:

- Burimet financiare dhe njerëzore përdoren me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Vlerat materiale administrohen mirë dhe ruhen nga keqpërdorimet;

janë përfshirë në programin vjetor të auditimit për vitin 2020, dhe planin strategjik 2020 – 2022 të gjitha auditimet e brendshme bazuar kryesisht ne organogramen e bashkise, te perputhshmerise, auditime te bazuara ne rrisk, rriskun e mashtrimit, financiare te menaxhimit dhe të drejtimit. Prioritet i është dhënë fushave me vlerësim të riskut më të lartë, ku dhe frekuenca e auditimeve natyrisht do te jete më e madhe.

Gjate planifikimit vjetor dhe strategjik jane mbajtur ne konisderate proceset e menaxhimit si:-

- Mbikqyrja e menaxhimit te rriskut strategjik dhe operacional dhe kontrollit.
- Sigurimin e nje performance menaxheriale efektive te njesise publike.
- Marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale.

Zona me risk të lartë:

- ✓ Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ne qytet dhe njesi administrative.
- ✓ Procedurat e prokurimeve publike, lidhja e kontratave dhe monitorimi i tyre.
- ✓ Administrimi i vlerave materiale dhe monetare si dhe pasurive te paluajtshme.
- ✓ Monitorimi mbikqyrja dhe ndihma e duhur ligjore e strukturave te bashkise ndaj shoqerive aksionere si aksioner i vetem per menaxhimin e fondeve publike qe i akordon.
- ✓ Krijimi dhe shlyerja e detyrimeve financiare te prapambetura te bashkise

2. Baza ligjore

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ligj i cili percakton rregullat kryesore për realizimin e procesit të auditimit të brendshëm, për të garantuar kryerjen e auditimit në përputhje me standartet si dhe percakton fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Akte të tjera nën ligjore të cilat janë pjesë e paketës ligjore, për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- Urdhëri i Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”
- VKM nr.83, datë 03.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- VKM nr.160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”.

3.Organizimi

3.1 Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm, është të mbështesë menaxhimin e lartë te bashkise për kryerjen e përgjegjësiave të tyre. Ky mision i auditit te brendshëm në Bashkine Peqin realizohet:

- Duke kryer vlerësime të pavarura të sistemeve të kontrollit dhe efijencës, bazuar në standartet profesionale të miratuara.
- Duke ndihmuar menaxhimin, nepermjet afrimit te analizave, rekomandimeve, këshillimeve dhe informacioneve lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.
- Duke mbështetur menaxhimin për arritjen e objektivave specifike, te matshem, te arritshem, te pershtatshem dhe ne kohe.

Vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e auditit të brendshëm në Bashkine Peqin janë integriteti, pavarësia, objektiviteti, ngritja e vazhdueshme profesinale, profesionalizmi, komunikimi dhe informimi.

Misioni i Auditit të Brendshëm në kete njesi administrative te pushtetit lokal, lidhet me përgjegjshmërinë dhe përgjegjësitë për aplikimin e legjislacionit të ri për auditin e brendshëm, për zhvillimin dhe implementimin e metodologjive, bazuar ne standartet dhe praktiket më të mira si dhe duke u mbështetur tek rekomandimet e adresuara nga audit i Bashkimit Evropian per veprimtarine dhe kapacitetet e auditimit te brendshem ne sektorin publik derguar me shkresen nr. 13492 date 16.07.2019 te DH/AB prane MFE.

3.2 Organizimi i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Peqin.

Struktura e auditimit të brendshëm bazohet në ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit, Kartën, dhe Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Peqin, funksionon me 1 (nje) pergjegjes dhe 2 (dy) auditues të brendshëm, sipas VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “ Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në njësitë publike”, nga te cilet ***Pergjegjesi i Sektorit te AB eshte i certifikuar si auditues i brendshem ne sektorin publik, nderkohe qe edhe nje nga dy punonjesit e tjere eshte ne proces certifikimi.***

Sektori i auditit të brendshëm, varet dhe raporton në Këshillin Bashkiak dhe Kryetarin e Bashkisë, sa i përket përgjegjësi dhe linjave të raportimit.

4. Analiza e veprimtarisë së auditit të brendshëm.

4.1 Analiza e programit të auditimit për vitin 2020.

Plani vjetor, përcakton qartë objektivat për t’u arritur, treguesit e matjes së performancës së auditimit, kapacitetet në dispozicion, si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Hartimi i planit vjetor per periudhen Janar – Dhjetor 2020 të auditimit të brendshëm dhe i planit strategjik 2020-2022 është bërë, duke zbatuar standartet në planin e punës për auditimin e brendshëm. Në planin strategjik dhe vjetor të SAB-së, janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e bashkisë. Përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë:

- Materialitetin sipas volumit - transaksionet me volum të madh, që i përkasin pagesave.
- Mungesën e rregulloreve specifike për fusha të ndryshme të domosdoshme.
- Mjedisi i kontrollit të brendshëm.

4.2 Gjetjet kryesore sipas sistemeve.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi sipas sistemeve, lidhen kryesisht me mosfunksionimin si duhet te sistemit të manaxhimit financiar dhe kontrollit, vecanerisht te GMS, parregullsi në procedurat e prokurimit publik me vlere te vogla me mjete elektronike, vonesa në zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, krijimi i detyrimeve financiare te prapambetura, rritja e stokut te detyrimeve financiare krijuar nga mosvjelja e taksave dhe tarifave vendore, etj. Niveli i riskut ka rezultuar mesatar dhe për rrjedhojë gjetjet janë të konsiderueshme, dhe kjo gjendje natyrisht kërkon ngritjen e nivelit te punës qe bëhet nga drejtoritë dhe sektoret e njesise publike për vënien në zbatim të rekomandimeve.

Ceshtje e Vecante : Gjetjet e auditimit te detyrimeve te prapambetura ne Bashkine Peqin.

Gjetje Nr. 1: Stoku i detyrimeve te prapambetura deri me 31.12.2019.

Pershkrimi i gjetjes.: - Sipas te dhenave te pasqyruara ne Pasqyrat Financiare dhe Bilancin e vitit ushtrimor 2019, konstatohet se totali i faturave te pa likuiduara ne fund te vitit 2019 ne llog 401 - 408 “Furnitor e llogari te lidhura me to”, dhe detyrimeve te tjera ne llog 467 “Kreditore te ndryshem”, paraqitet ne vleren **54.671.273** leke, detyrim i Bashkisë Peqin ndaj sublekteve private, nga te cilat :

- | | | | |
|------------------------------------|---|------------|-------------------|
| - Detyrime per Investimet | = | 27,422,714 | leke ne 9 raste. |
| - Detyrime per Mallra dhe sherbime | = | 21,675,491 | leke ne 15 raste. |
| - Detyrime Vendime Gjyqesore fp | = | 4,313,888 | leke ne 2 raste. |
| - Detyrime Te Tjera | = | 1.259,180 | leke |

Sipas kategorive, zëri "Investimezë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 50 %, zëri "Mallra dhe Sherbime" me rreth 39,6 %, "Vendime Gjyqësore" me rreth 7,9 % dhe zëri "Te Tjera (shpenzime lindje)" me 2.3 %.

Gjetje Nr. 2: Stoku i detyrimeve te prapambetura deri me 30.06.2020.

Pershkrimi i gjetjes: - Vlera e faturave te palikuiduara gjendje deri me 30.06.2020, te pasqyruara ne llog 401 - 408 "Furnitor e llogari te lidhura me to" dhe detyrime te tjera ne llog 467 "Kreditore te ndryshem", paraqitet ne vleren **39.367.573** leke ndaj subjekteve private dhe konkretisht:

- Investime = 14.459.787 leke
- Mallra dhe sherbime = 9.557.664 leke
- Vendime Gjyqësore = 14.742.057 leke
- Te Tjera = 588.065 leke.

Sipas kategorive, zëri "Vendime Gjyqësore" me rreth 37,4 % zë peshën më të madhe të stokut të detyrimit, zëri "Investime" me rreth 36,7 %, zëri "Mallra dhe Sherbime" me rreth 24,3 %, dhe zëri "Te Tjera (shpenzime lindje)" me 1.5 %.

Gjetje Nr. 3: Stoku i detyrimeve te prapambetura deri me 30.09.2020.

Pershkrimi i gjetjes: - Duke marre ne konsiderate shlyerjet e detyrimeve te prapambetura te bera pergjate periudhes Janar-Shtator/2020, deri me 30.09.2020 stoku i detyrimeve te prapambetura qe jane pa likujduar sipas viteve te krijimit te tyre dhe zerave te shpenzimeve eshte **35,241,355 leke**, ose 19,429,918 leke me pak se gjendja ne fund te vitit 2019, dhe 4,126,218 leke me pak se gjendja me 30.06.2020, pra stoku i detyrimeve te prapambetura ka ardhur me ulje nga viti ne vit, dhe konkretisht :-

- Detyrime per Investimet = 13,060,901 leke ne 9 raste.
- Detyrime per Mallra dhe sherbime = 6,182,285 leke ne 13 raste.
- Detyrime Vendime Gjyqësore fp = 9,928,169 leke ne 2 raste.
- Detyrime Te Tjera (Shperblim Lindje) = 6.070,000 leke.

Sipas kategorive, zëri "Investime" zë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me 37 %, zëri "Vendime Gjyqësore" me rreth 28,2 %, zëri "Mallra dhe Sherbime" me rreth 17,5 %, dhe zëri "Te Tjera (shpenzime lindje)" me 17.2 %.

Sipas viteve te krijimit dhe arsyeve te mos likujdimit ne kohe te ketyre detyrimeve financiare, ato paraqiten si me poshte:-

- Sherbime telefonike nga Albtelekom viti i krijimit 2009-2010, shuma e palikujduar eshte **1,770,035 leke**, detyrim ky i mbartur nga ish - komunitet dhe i palikujduar, me pretendimin e mungeses se dokumentacionit justifikues dhe fondeve disponibel. Ne proces likujdimi.
- Shpenzime gjyqësore permbarimore te formes se prere ne total **10,040,969 leke** e ndare ne vite:- Ne vitin 2018 = 112,800 leke, dhe ne vitin 2020 = 9,928,169 leke, Pretendimi:- Paaftesi financiare. Vazhdojne te likujdohen pjeserisht ne marreveshje me permbaruesit dhe thesarin.
- Shperblime lindje te viteve 2016 - 2020 ne vleren **6,070,000 leke**. Arsyeja e moslikujdimit : Mungese fondesh. Fondi alokohet nga Ministria e linjes me transferte. Megjithese jane bere kerkesa te vazhdueshme zyrtare nga ana e Drejtorise se Finances, ky detyrim mbetet pa u shperndare perfutur.
- Rikonstrukcion rruges Y. Beheluli, shuma e palikujduar **2,680,169 leke**, viti 2017 i krijimit detyrimit. Nuk eshte shlyer pasi rruga nuk eshte marre akoma ne dorezim.
- Sistemim, asfaltim i rruges „Ali Çeka“ Peqin, shuma e mbetur pa likujduar **9,182,000 leke**, investim nga burimet e veta, ne likudim e siper.
- Blerje Naftë, detyrimi i krijuar dhe mbetur pa likujduar gjate vitit 2020, shuma e mbetur pa likujduar eshte **1,864,000 leke**, shkak i krijimit te detyrimit mungese te ardhurash. Ne proces likujdimi.
- Blerje mallra dhe materiale te ndryshme ne 7 raste pergjate vitit 2020 ne shumen **1,302,960 leke**. Arsyeja e krijimit sipas specialisteve te finances eshte mungesa e te ardhurave gjate vitit 2020.
- Studime dhe projekte te ndryshme ne shumen **944,400 leke** krijuar gjate vitit 2020, ne proces likujdimi.
- Mbikqyrje dhe kolaudime punimesh te kryera gjate vitit 2020, ne shumen **306,132 leke**, ne proces likujdimi.
- Sherbimi postar 0,6 % detyrim i krijuar gjate periudhes Janar-Shtator/2020 ne vlkeren **1,080,690 leke** per mungese te ardhurash. Ne proces likujdimi.

Gjetje Nr. 4: Mbi efektet e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prërë në buxhetin e bashkise gjatë periudhës objekt auditimi.

Pershkrimi i gjetjes: - Per periudhen objekt auditimi janë administruar nga financa 3 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prërë, vendime këto të mbartura edhe gjatë periudhës së auditimit, në vlerën 12,160,857 leke, efekt ky negativ në buxhetin e bashkise, këto janë detyrime të mbartura nga ish komunat, është arritur të likujdohet vlera 7,846,959 leke perkatesisht në vitin 2019 dhe ka mbetur pa u likujduar në buxhetin e vitit 2020 e në vijim vlera 4,313,888 leke dhe për vitin 2020 shtohet dhe një tjetër vendim gjyqësor i formës së prërë në vlerën 10,928,169 leke nga të cilat për 6/mujorin e parë të vitit 2020 janë likujduar vlera 500,000 leke dhe mbetet për likujdim për 6/mujorin e dytë të vitit 2020 e në vijim shuma 14,742,057 leke. Nga rakordimi i të dhenave lidhur me kontratat dhe urdherat e përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të formës së prërë të mbetura të papaguara pas datës së përcaktuar në kontratë apo me ligj, evidentohen gjithsej **9,928,169 leke** detyrime të pashlyera **deri më 30.09.2020**, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 62 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ku përcaktohet se; “*..Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prërë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njërive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësi administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi..*”.

Detyrimet e prapambetura të evidentuara me sipër kanë rezultuar nga rakordimi i totalit të gjendjes në celje të periudhës në fillim të vitit ushtrimor me raportimin në FRU/MFE për periudhën paraardhëse deri më 30.09.2020. Janë evidentuar dhe kontrolluar të gjitha shlyerjet e bera përgjatë periudhës objekt auditimi me planin e shlyerjeve të hartuar nga Drejtoria e Finances dhe të dërguar pranë MFE.

Është bërë rakordimi i gjendjes në mbyllje të periudhës me raportimin në FRU/MFE për periudhën raportuese dhe nuk kanë rezultuar diferenca.

Është bërë gjithashtu rakordimi i gjendjes në mbyllje të periudhës me librin e madh të kontabilitetit dhe nuk kanë rezultuar diferenca.

Është bërë rakordimi i totalit të gjendjes në mbyllje të periudhës me totalin e llogarise së detyrimeve të prapambetura sipas SIFQ dhe nuk rezultuan diferenca. Nga shqyrtimi i dokumentacionit analitik konstatohet se Drejtoria e Finances nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit nga pamjaftueshmëria e aftësisë paguese, faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare etj.

Gjetje Nr. 5: Mbi moszbatimin e nenit 46 të Ligjit nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”.

Pershkrimi i gjetjes: - Për periudhën e viteve 2019 dhe 2020 u konstatua se nuk është bërë analiza dhe miratimi në Këshillin Bashkiak i procesit të realizimit të treguesve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 të Ligjit nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”.

Nga analiza e realizimit të treguesve faktike të buxhetit konstatohet se për vitin 2019 treguesit e buxhetit të bashkise janë realizuar në total në vlerën 672,117 mijë leke ose 90.8 %, pagat janë realizuar në masën 88,7 %, shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 85,5 %, dhe investimet janë realizuar në masën 87 %. Të ardhurat e veta të bashkise për financimin e treguesve të buxhetit faktik të këtij viti janë në masën 67,407 mijë leke ose 10 % e totalit.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë paguar detyrimet kreditore të krijuara në vitin ushtrimor si dhe ato të trashëguara nga vitet paraardhëse, megjithatë në fund të vitit ushtrimor, kanë rezultuar burime financiare të paperdorura konkretisht:-

Në fund të vitit 2019 kanë rezultuar të paperdorura fonde në shumën 34.766 mijë leke të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2020, praktike kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 101, të UMF Nr.2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Në mënyrë të përmbledhur sipas periudhave të krijimit dhe shlyerjes të këtyre detyrimeve, kemi të dhenat e mëposhtme:-

Totali i detyrimeve të krijuara gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019 është 112,867,452 leke të ndara sipas kategorive:-

- Investimet = 45,900,668 leke.

- Mallra dhe shërbime = 60,634,434 leke.

- Vendime gjyqesore = 22.379,466 leke.
- Te Tjera = 7,790,000 leke.

Detyrime te krijuara pergjate periudhes Janar - Shtator 2020 jane gjithsej:-

- 3/mujori I-re Janar-Mars/20 = 4,632,975 leke (Investime =4,632,975 leke);
- 3/mujori II-te Prill-Qershor/20 = 10,777,874 leke: (Investime = 349,705 leke dhe 10,428,169 leke V.GJ.
- 3/mujori III-te Korrik-Shtator/20 = 2,103,000 leke (mallra dhe sherbime).

Totali i detyrimeve te krijuara deri ne 30.09.2020 eshte 164,450,020 leke, nga te cilat:-

- 55,460,608 leke Investimet;
- 67,951,777 leke Mallra dhe Sherbime;
- 32,807,635 leke Vendime Gjyqesore dhe
- 8,230,000 leke Shperblim Lindje.

Detyrime te prapambetura te shlyera gjate viteve 2015; 2016; 2017; 2018 dhe 2019 jane gjithsej 97,018,128 leke te ndara sipas kategorive:-

- Investimet = 34,444,821 leke.
- Mallra dhe sherbime = 40,577,694 leke.
- Vendime gjyqesore = 19,835,613 leke.
- Te Tjera = 2,160,000 leke.

Detyrime te shlyera pergjate periudhes Janar - Shtator/2020 jane gjithsej 32,190,537 leke te ndara sipas kategorive:-

- Investimet = 7,954,886 leke;
- Mallra dhe sherbime = 21,191,798 leke;
- Vendime gjyqesore = 3,043,853 leke.

Totali i detyrimeve te shlyera pergjate viteve deri ne vitin 2015; 2016 ; 2017; 2018; 2019 dhe Janar-Shtator/2020,

jane gjithsej 129,208,665 leke te ndara sipas kategorive :-

- Investimet = 42,399,707 leke ;
- Mallra dhe sherbime = 61,769,492 leke;
- Vendime gjyqesore = 22,879,466 leke dhe
- Te tjera = 2,160,000 leke.

Detyrimi i mbetur deri ne 30.09.2020 eshte :- Vlera totale = 35,241,355 leke, nga te cilat :-

- etyrime per Investimet = 13,060,901 leke ne 9 raste.
- Detyrime per Mallra dhe sherbime = 6,182,285 leke ne 13 raste.
- Detyrime Vendime Gjyqesore fp = 9,928,169 leke ne 2 raste.
- Detyrime Te Tjera (shperblim lindje) = 6.070,000 leke.

Shenim: Ne zerin investime jane perfshire krahas investimeve te bashkise nga burimet e veta edhe investimet e financuara nga FZHR.

Drejtoria e Finances prane Bashkise Peqin ka hartuar planin e shlyerjes se detyrimeve te prapambetura per vitin 2019 dhe per periudhen afatmesme 2020 deri me 2022 dhe nje kopje eshte derguar prane MFE.

Plani i shlyerjes i hartuar eshte regjistruar kundrejt fondeve buxhetore ne SIFQ per vitin 2019 dhe per periudhen afatmesme 2020-2022.

Verifikimi i regjistrat te prokurimeve per fondet publike, mallra, sherbime, pune publike te depozituar prane Deges se Thesarit, ne fillim te cdo viti buxhetor, si dhe ndaj cdo rishikimi te tij gjate vitit ushtrimor.

Nga verifikimi dhe kontrolli i zbatimit te regjistrave te parashikimit te prokurimeve me regjistrat e realizimit te prokurimeve publike per vitet 2019 dhe 2020 duke kryezuar elementet perberes, nuk u konstatuan mosperputhje dhe devijime te ndjeshme ne zera dhe vlere ndermjet tyre. Vetem ne nje rast konkretisht ne objektin "Rikonstruksion i rruges Sulejman Bej Peqini" ishte bere ndryshimi i objektit te procedures se prokurimit. Per rastet e ndryshimeve te zerave te vecante ne planin e parashikuar te prokurimeve publike, jane bere shpjegimet perkatese bashkengjitur pasqyres se realizimit te prokurimeve publike.

Verifikimi i respektimit te shlyerjes se detyrimeve te prapambetura per secilen kategori, sipas parimit te radhes kohore te krijimit te detyrimit financiar dhe sipas sektoreve.

GJETJE Nr. 6:- Lidhur me zbatimin e parimit FIFO (hyrja e pare - dalja e pare) ne shlyerjen e detyrimeve te prapambetura nga auditimi me përzgjedhje i kampionit të marrë, u konstatuan disa raste te mos zbatimit rigoroz

te ketij parimi, gje e cila tregon per veprime jo ne perputhje me detyrimet ligjore nga nenpunesi zbatues i kesaj drejtorie. Ne piken 106 te Udhëzimit nr. 9 date 20.07.2018 *“Per procedurat standart te zbatimit te buxhetit”* thuhet:- *“Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”*. Mos zbatimi i ketij udhezimi perben shkelje te disiplines financiare nga ana e punonjesve pergjegjes.

Krijimi i stokut te detyrimeve të prapambetura, do te rëndojë buxhetin e viteve në vazhdim, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Auditimi i regjistrimit, evidentimit ne kontabilitet si dhe ne Sistemin Informatik Financiar te Qeverise (SIFQ) te DTH te detyrimeve te prapambetura dhe te shtesave te kontratave. Verifikimi i dokumentacionit mbeshtetes dhe proedurave per perfshirjen e detyrimeve financiare ne listen e shlyerjes se tyre.

GJETJE Nr. 7:- Në hartimin e buxhetit vjetor në zërin e shpenzimeve, nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura, në këtë zë ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për këtë zë për vitin 2016, 2017, 2018 dhe 2019 janë realizuar respektivisht në masën 79%, 90% , 87% dhe 90,8 %.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Planifikimi i zërit të shpenzimeve është bërë pa llogaritur detyrimet për faturat e pa likuiduara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *“Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”*, Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, *“Për buxhetin e vitit 2019”*, pikat 106-110, *“Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”* dhe pikat 116-117 *“Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njesite e qeverisjes vendore”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit mbeshtetes dhe procedurave per perfshirjen e detyrimeve financiare ne listen e shlyerjes se tyre, per rastet e verifikuara, nuk u konstatuan mungese te dokumentacionit perkates, me perjashtim te detyrimit per *“Sherbime telefonike nga Albtelekom”*, viti i krijimit 2009-2010, shuma e palikujduar eshte **1,770,035 leke** , detyrim ky i mbartur nga ish - komunitat dhe i palikujduar, me pretendimin e mungeses se dokumentacionit justifikues.

GJETJE Nr. 8:- Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Finances nuk eshte bere identifikimi i rrisqeve, hartimi i rregjistrimit te rriskut, vleresimi dhe menaxhimi i rriskut per fushen e krijimit te detyrimeve te prapambetura, si një element kyç për realizimin e objektivave, ne lidhje me programimin, realizimin dhe raportimin e te dhenave te aktivitetit ekonomik dhe financiar te bashkise ne teresi.

Fusha me risk te larte jane:-

- Krijimi i stokut te detyrimeve te prapambetura ne teresi dhe zeri per shpenzimet gjyqesore (permbarimore) ne veçanti.

5.1 Rekomandimet e propozuara:

Misioni i funksionit të Auditimit të Brendshëm, është dhënia e rekomandimeve të zbatueshme dhe që i shtojnë vlerë subjektit të audituar. Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë qëllim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut dhe dhënien e këshillave për zgjidhje, që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Gjatë auditimeve dhe kontrolleve tematike janë dhënë rekomandimet si më poshtë:-

I- REKOMANDIMET E DHENA PER DETYRIMET E PRAPAMBETURA TE BASHKISE: **Rekomandimi 1 :**

Drejtoria e Finances te nderprese praktiken e krijimit te detyrimeve te reja te prapambetura dhe te marre masa per likuidimin e detyrimeve totale te tyre duke hartur plan te detajuar per kete qellim. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të menaxhohet në mënyrë transparente, pagesat të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit të dokumentacionit që vërteton kryerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave. Radha e pagesës të ndryshojë vetëm nëse ka parregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

Rekomandimi 2 :

Drejtoria e Finances duhet te parandaloje proceset e ri-krijimit të detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, bashkia te zhvilloje një analizë të shkaqeve të pagesave të vonuara dhe te miratojë masa specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve. Zbatimi i suksesshëm i këtyre masave do të kërkojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave ligjore nga ana e titullarit, nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe stafit mbështetës të tyre. Sanksionet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi duhet të zbatohen në rastet e shkeljes së kërkesave ligjore e nënligjore.

Masat për forcimin e disiplinës financiare përfshijnë:

1. Sigurimin e financimit të mjaftueshëm në vitin ushtrimor dhe në vitet në vazhdim përpara se të fillojë prokurimi, kjo bazuar në disponibilitetin e fondeve buxhetore për të gjitha detyrimet e marra përsipër nga Bashkia.
2. Si një masë e nevojshme kontrolli, rregjistrimi i prokurimeve të depozitohet zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit, në fillim të vitit buxhetor, si dhe cdo rishikim i tij gjatë vitit. Në cdo rast shuma totale e prokurimeve të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor ose për më shumë se një vit (për kontratat shumë vjeçare të investimeve). Mbi këtë bazë edhe respektimi i angazhimeve të monitorohet dhe kontrollohet nëpërmjet sistemit informatik financiar (SIFQ).
3. Duke filluar nga Janari 2022, të gjithë urdhrat e prokurimit për mallrat, shërbimet dhe investimet e nxjerra gjatë vitit, përveç blerjeve emergjente, **duhet:**

- T'i përmbahen regjistrimit të prokurimeve publike të parashikuara të dorëzuar në thesar,
- Të vulosen nga dega e thesarit nëse ka fonde buxhetore në dispozicion të bashkise, përpara procedimit sipas rregullave të prokurimit publik. Për mallrat, shërbimet dhe investimet, për të cilat ka nisur procesi i tenderimit, të paraqitet kontrata në degën e thesarit, për tu kontrolluar kundrejt fondeve disponibël dhe vulosur, përpara nënshkrimit të saj nga Nëpunësi autorizues i Bashkise. Dega e Thesarit të refuzojë me shkrim një urdhrë prokurimi, apo kontratën si më lart, të pambuluar me fonde publike dhe për këtë të njoftojë Agjensinë e Prokurimit Publik, e cila e publikon në faqen e internetit.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të menaxhohet në mënyrë transparente nëpërmjet një procesi të miratuar brenda kriterëve të vendosura në strategjinë e zhvillimit afatmesëm të bashkise. Ky proces të fillojë pasi detyrimet financiare të prapambetura të jenë verifikuar rregullisht dhe masat institucionale për mbikëqyrjen e procesit të jenë miratuar.

Rekomandimi 3:

Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **35,241,355 leke**. Për këtë qëllim, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 “Per zbatimin e buxhetit të vitit 2020”. pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitet e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave. Në zbatim të pikës 88 të udhëzimit të mësipërm të bëjë publikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit.

Drejtoria e Financës të marrë masa për: -

- Zbatimin e procedurave ligjore në programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesëm, duke ngritur në kohën e duhur, grupet e punës sipas projekteve të financimit, si dhe të monitorohet zbatimi i kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.
- Programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. –
- Të miratojë në Këshillin Bashkiak raportet e monitorimit të treguesve të buxhetit, si organi vetëm vendimmarrës, si dhe të gjitha fondet që akordohen bashkise nga burimet e veta, buxheti i shtetit apo donator të ndryshëm në fillim dhe gjatë vitit ushtrimor, për të siguruar një transparencë të mirpërdorimit të këtyre fondeve me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në të mirë të komunitetit.
- Programimin dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura duke miratuar një kalendar mbi bazën e mundësive financiare dhe riskut nga penalitete të mundshme.

Rekomandimi 4:

Te merren masa për planifikimin dhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura prej **9,928,169 leke** që rrjedhin nga urdherat e përbashkët gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të formës së prere. Ketu vlen të parashtrijme

rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe futjen e tyre në procesin e ekzekutimit buxhetor, duke marrë parasysh efektin e mundshëm në vitet e ardhshme në formën e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe trajtimin e plotë të përgjegjësisë në lidhje me vendimmarrjen me kosto financiare të nënpunësve publike, në të njëjtën linjë me kërkesën e vazhdueshme për hartimin dhe miratimin e ligjit “Për përgjegjësinë materiale”.

Rekomandim 5:

Te behet e detyrueshme analiza dhe miratimi ne Keshillin Bashkiak i procesit te realizimit te treguesve te buxhetit brenda dates 30 Qershor, ne perputhje e zbatim te kerkesave te nenit 46 te Ligjit nr 68/2017 “Per financat e qeverisjes vendore”. Drejtoria e Finances te nderprese praktiken e krijimit te detyrimeve te reja te prapambetura dhe te marre masa per likuidimin e detyrimeve totale te tyre duke hartur plan te detajuar per kete qellim.

Rekomandim 6:

Te zbatohet ne menyre rigoroze parimi FIFO (hyrja e pare - dalja e pare) ne shlyerjen e detyrimeve te prapambetura. Per kete likuidimet duhet te kryhen sipas rradses kronologjike te krijimit te tyre. Pra lëshimi i urdhër-pagesave duhet të bëhet pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm si edhe plotësimit të specifikimeve teknike të mallit (kur bëhet hyrje në magazinë).

Rekomandim 7:

Nga Drejtoria e Finances të analizohet situata lidhur me planifikimin, realizimin e buxhetit dhe krijimin e faturave të pa likujduara dhe të nxirren përgjegjësitë.

Gjithashtu të marren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave.

Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave në vitin e mëparshëm buxhetor. Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore (30 ditë), duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin.

Rekomandim 8:

Te behet identifikimi, vleresimi dhe menaxhimi i riskut nepermjet hartimit te Regjistrit te Riskut dhe matrices se riskut, per cdo proces, aktivitet, transaksion financiar te perfshire ne aktivitetin e Drejtorise se Finances per periudhen ne vazhdim. Te behet hartimi i planit te masave qe parashikohet te ndermerren per parandalimin e krijimit te ketyre detyrimeve ne te ardhmen. Te behet verifikimi i plote i dokumentacionit mbeshtetes dhe proedurave per perfshirjen e detyrimeve financiare ne listen e shlyerjes se tyre. Te zbatohet rigorozisht ne te ardhmen parimi i radhes kohore (parimi FIFO) te shlyerjes se detyrimeve te prapambetura.

II- REKOMANDIMET E DHENA NE NJESINE ADMINISTRATIVE GJOCAJ.

Rekomandim 1.

1.Te behen derdhje me te shpeshta ne banke qe te mos kalohet limiti i arketimeve konform Udhezimit te Ministrise Financave nr.30 date 27.12.2011 “Per Menaxhimin e Aktiveve ne Njesite e Sektorit Publik”.

Rekomandim 2.

2. Sektori Tatim/Taksave ne njesi të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore, në shumën gjithsejt prej 19,060,572 leke. lekë, respektivisht:

- detyrimet për taksat dhe tarifatat të familjarëve në vlerën	=	15,829,207 leke.,
- vlerën totale të debisë për bizneset (detyrim/ pa kamatë) është	=	3,231,365 leke..

Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 19,060,572 leke, të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a) Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar .

b) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

c) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset nuk paguajnë detyrimet, Bashkia te zbatoje ndaj tyre dhenien e masave administrative, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

c) Drejtoria e Taksave në Bashki të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e Njësise Administrative Gjocaj.

d) Të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifrat etj .

e) Ne bashkepunim me Drejtorinë e Tatim Taksave në Bashki të merren masa për regjistrimin e bizneseve të paregjistruara duke dërguar informacion pranë DRTTE.

Rekomandim 3.

3. Të rritet bashkepunimi ndërmjet Njësise Administrative Gjocaj, Drejtorisë së Financave/Ekonomisë, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, dhe Agjencisë së Bujqësisë pranë Bashkisë, për të marrë masat e duhura për rishikimin dhe plotësimin me formatin e duhur ligjor, duke eliminuar te metat dhe pasaktesitë si dhe për të noterizuar kontratat për asetet si me lart duke përcaktuar saktë qerane në vlerë monetare vjetore si dhe subjektin që do të monitorojë dhe administrojë të ardhurat.

Rekomandim 4.

4. Nga komisioni i inventarizimit të mbahet proces – verbali për fiksimin e numrit rendor të flete hyrjes dhe flete daljes së magazines sic çilesohet në Udhezimin e Ministrisë së Financave nr 30 datë 27.12.2011 .” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti të Sektorit Publik” pika 83.

Rekomandim 5.

5. Të mbahet Regjistri i Aktiveve që zoteron apo ka në administrim njesia, përfshi pronat publike, siç parashikohet në Piken III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes së tyre”, pika 26 i Udhezimit të Ministrisë së Financave nr 30 datë 27.12.2011.”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti të Sektorit Publik”.

Rekomandim 6.

6. Deklaratat 3 mujore dhe formulari i aplikimit të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të printohen çdo tre muaj dhe të firmosen nga të gjithë anëtarët madhore bazuar në VKM nr. 955, datë 07.12.2016 ” Për përcaktimi kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE” , kreu II pika 3 I ndryshuar me VKM nr. 592, datë 18.10.2017”Për disa shtesa dhe ndryshime dhe shtesa në VKM nr.955 ,datë 07.12.2016 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike ”.

Rekomandim 7.

7. Të plotësohen dosjet me certifikatat familjare si dhe dokumentat e tjera të cilat mungonin në dosje konform VKM nr. 955, datë 07.12.2016 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike ” i ndryshuar Kreu I pika 4.1 , germa b.

Rekomandim 8.

8. Të vazhdojë menjëherë verifikimi i familjeve të skemës së Ndihmës Ekonomike në zbatim të nenit 31 pika b, të ligjit 9355 dt 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore “ (i ndryshuar), si dhe të plotësohen formularët e verifikimit të situatës social - ekonomike të familjeve në bazë të VKM 955 datë 07.12.2016. Nga administratori të behen intervistime dhe verifikime të Gjendjes social – ekonomike jo më pak se dy herë në vit për të gjitha familjet përfituese.

Rekomandim 9.

9. Për periudhën e ardhshme të plotësohen dosjet me fotokopjen e librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm.

Rekomandim 10.

10. Dosjet të plotësohen me Kopjet e Vertetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Paaftësisë për Punë sipas VKM nr. 955, datë 07.12.2016 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar Kreu I, pika 4.1.2.

Rekomandim 11.

11. Të plotësohet dosja e Endri Xhyres me dokumentacionin e nevojshëm si dhe të behet pagesa e kujdesarit për muajin e munguar.

Rekomandim 12.

12. Të mbahen rregullisht çdo fund muaj akt-rakordimet me zyrën e Postës Shqiptare që bën shpërndarjen e pagesave për familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike.

Rekomandim 13.

13. Te merren masat e duhura nga Administratori i njesise dhe Drejtoria e Mireqenjes dhe Kujdesit social per zhvillimin e shpejte te procedures se marrjes ne dorezim me proces verbal te rregullt te dokumentacionit qe gjendet ne kete sektor, nepermjet ngritjes se nje komisioni.

Rekomandim 14.

